REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR DATË 13.06.2022

Me datë 13.06.2022, u mbajt mbledhja e këshillit bashkiak Shkodër.Këshilltarë të pranishëm ishin: Brisela Kadija,Teuta Zaja, Bledianë Nika, Nersada Mandija, Aurora Dibra, Diana Muriqi, Jona Leqejza, Sabahete Lishi, Age Martini, Sabina Danaj,Donika Ndoja, Valbona Doniku,Ornela Leka, Gezim Galiqi, Erion Metushi, Oltion Luli, Hilmi Lakti, Gerald Hasaj, Sokol Zaimaj,Hekuran Gjorreta, Besmir Vukaj, Anton Deda, Blerim Dimnaku, Gjergj Sokoli ,Luigj Palushi, Arbis Vjerdha, Lindita Nika, Nadir Spahija.

Mbledhja hapet nga Kryetarja e Këshillit, znj. Brisela Kadija.

Rendi i ditës së mbledhjes vazhduese është si vijon:

3. *Dikutime mbi projekt- aktin për planin lokal për veprimin e zhurmave në mjedis.(Ref. kërkesë inicuar nga këshilltar nr.8488,dt.26.05.2022)*
4. Pr/Vendim: *"Për miratimin e rregullores për krijimin,organizimin dhe funksionimin e këshillit vendor për sigurinë publike në Bashkinë Shkodër".*
5. Pr/Vendim: *"Për miratimin e rregullores për kodin e sjelljes dhe parandalimin e konfliktit të interesave të këshilltarit bashkiak".*
6. Pr/Vendim: *"Për miratimin e raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit viti 2021,të Bashkisë Shkodër".*
7. Pr/Vendim: *"Për miratimin e vlerës së subvencionimit të qirasë dhe përjashtimin nga pagesa e qirasë të përfituesve të subvencionimit në raport me nivelin e të ardhurave për përfituesit e banesave sociale me qira,administruar nga bashkia Shkodër".*
8. Pr/Vendim: *"Për angazhimin e burimeve financiare të Bashkisë Shkodër për bashkëfinancim në aplikimin nr.Ref: EU4M-CFP1-A2;Për angazhimin për mbulimin e kostove të mirëmbajtjes së projektit dhe për autorizimin e kryetarit për lidhjen e kontratës së grantit".*

9. Pr/Vendim: *"Për shtesë në buxhetin e vitit 2022 e miratuar me VKB nr.3,datë 05.01.2022"Për miratimin e buxhetit të vitit 2022 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2022-2024 të Bashkisë Shkodër".*

10. Pr/Vendim: *"Për miratimin e ndryshimit të emërtimit të rruga e "Korpusit"në rruga "Kolë Mjeda".*

11. *Diskutime jashtë rendit të ditës.*

Kourumi i domosdoshëm është i pranishëm në sallë,prandaj vijohet me pikën 4 të rendit të ditës, pasi për pikën 3 të rendit të ditës të mbledhjes vijuese, këshilltari Anton Deda i cili ishte dhe propozuesi i kësaj pike, kërkoi të hiqej.
Fjalën e merr Z.Deda,zv/kryetar i bashkisë,i cili relaton sipas materialit të përgatitur nga punonjësit e administratës. Ai sqaron se Pr/Rregullorja është vendosur në dispozicion të të gjithë strukturave të këtij këshilli,të cilët kanë bërë edhe ndryshimet përkatëse në nenet 2,5 dhe 13. Bashkia e Shkodrës është dakort dhe kërkon sot miratimin e saj me ndryshimet e propozuara.
Z.Vjerdha shprehet krejtësisht dakort me miratimin e rregullores por si anëtar i komisionit të sigurisë publike i rezulton që Policia Bashkiake ka 28 policë, në një kohë që shumë pak janë në terren dhe puna e tyre lë kështu shumë për të dëshiruar. Së dyti, përsa i përket kamerave të sigurisë të vendosura nga bashkia, ai ka informacion që nuk funksionojnë. Ai kërkon të dijë a ka ndonjë projekt që këto kamera të vendosen në akse më problematike, ku realisht shërbejnë? Së treti, para disa kohësh ai ka depozituar një kërkesë pranë Kryetares së bashkisë në lidhje me rregulloret e brendshme të drejtorive, ku rezulton që 80% e tyre nuk e kanë një të tillë, a do merret ndonjë masë për këtë?
Z.Deda përgjigjet duke u shprehur se këto pyetje do mund të marrin përgjigje në momentin e funksionimit të këshillit vendor të sigurisë publike, aty do mund të diskutohen me strukturat e tij. Kurse përsa i përket rregullores së brendshme është e drejtë ç'ka u tha sepse rregullorja i shërben funksionimit dhe mirorganizimit të punës brenda drejtorisë, por do merren masa për këtë shumë shpejt.
Z.Vjerdha shprehet se në emër të këshillit vendor të sigurisë janë justifikuar investime të tjera dhe ai mendon se qytetarët taksapagues kanë të drejtën e një përgjigjeje më të saktë. Po ashtu përsa i përket rregullores së brendshme të drejtorive mendon se duhet të vendoset një afat, sepse ka më shumë se 3 vjet që e kërkon një gjë të tillë dhe nuk është marr asnjë masë.
Fjalën e merr Kryetari Bashkisë Z.Bardh Spahia i cili sqaron se ekziston një rregullore e brendshme që rregullon punën dhe funksionimin e të gjitha drejtorive. Gjithashtu ai informon që kamerat e sigurisë në qytetin e Shkodrës funksionojnë në shumicën dërmuese të tyre. Madje ai thekson se ka një komunikim të vazhdueshëm me Komisariatin e Policisë sa herë që ka ngjarje dhe mbështetja është dhënë pothuajse në kohë reale.
Fjala është për Z.Galiqi,i cili mendon se hapi i parë është miratimi i kësaj rregulloreje, pastaj mund të diskutohet me personat e zgjedhur në lidhje me propozime, këshilla dhe kërkesa të cilat janë vërtetë të rëndësishme përsa i përket sigurisë publikë në Shkodër.
Znj.Truma,sqaron se komisioni i sigurisë ka për detyrë të informojë Bashkine e Shkodrës, kështu do kemi mundësi për rekomandime dhe propozime edhe në mbledhjet e ardhshme.

Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 28 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.
Miratohet

Vijohet me pikën 5. të rendit të ditës: Pr/Vendim: *"Për miratimin e rregullores për kodin e sjelljes dhe parandalimin e konfliktit të interesave të këshilltarit bashkiak".*

Znj.Kadija thekson që ky Pr/Vendim vjen si vazhdim i nenit 139 për vetqeverisjen vendore dhe i një sërë aktesh të tjera ligjore, mbështetur nga Bashkitë e Forta te Shqipërisë. Ky pr/akt vjen si nevojë për të rritur besimin dhe transparencën e publikut në lidhje me funksionin e këshilltarit bashkiak duke realizuar kështu pritshmëritë e qytetarëve.

Z.Vjerdha kërkon të dijë,se në c'mënyrë dhe kush do e gjykojë nëse ndonjë anëtar është treguar abuzues me postin e anëtarit të këshillit bashkiak?

Për detajet teknike flet sekretari i këshillit Z.Lesha ,i cili sqaron se është parashikuar krijimi i një komisioni etike,që do vendosë për abuzimet e mundshme,në mungesë të tij Kryesia e këshillit.

Znj.Kadija sqaron edhe një herë se kjo rregullore iu është paraqitur anëtarëve të këshillit që në 2021 dhe beson që ka qënë kohë e mjaftueshme për rekomandime dhe propozime të cdo lloji.

Z.Vukaj,citon paragrafin e 2 të pikës 3 të nenit 5 të kësaj rregulloreje.Ai mendon që nuk është marr parasysh neni 22 i Kushtetutës në hartimin e kësaj dispozite.

Përsëri Znj.Kadija sqaron se sipas rregullores së këshillit propozimet për ndryshime të Pr/akteve duhen të vijnë minimalisht 24 orë para mbledhjes. Kjo rregullore do kaloj kështu ose nuk do miratohet nga anëtarët e këshillit,sepse nuk mund të bëhen ndryshime në mbledhjen e këshillit.

Z.Galiqi shprehet dakort për miratimin e rregullores duke theksuar rëndësinë e saj ,sepse shpesh herë ka pasur precendent të cënimit të etikës.

Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 26 vota Pro, 1 Kundër, 1 Abstenim.
Miratohet

Vijohet me pikën 6. të rendit: Pr/Vendimin: *"Për miratimin e raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit viti 2021,të Bashkisë Shkodër".*

Përsëri N/Kryetari i Bashkisë merr fjalën dhe relaton sipas materialit të përgatitur nga punonjësit e administratës.

Fjalën e merr znj.Leqejza e cila shprehet se ne lidhje me projekt aktin e marre ne shqyrtim nga komisionit I kontrollit financiar dhe mbledhjes se kryer me ekzekutivin, shprehemi pa rezerva sa i perket miratimit te aktit. Behet fjale per nje akt formal fakti dhe nuk eshte ne tagrin tone verifikimi dhe auditimi i vlerave dhe metodave te njohjes kontabel, po ashtu edhe per gjykimet kontabel te ushtruara. Ne te njejten kohe, nuk verejme ndonje indicie per ta vene ne diskutim sa me lart.

Nga ana tjeter, ajo qe ne kuptojme nga ky bilanc i konsoliduar eshte qe menaxhimi i disa proceseve esenciale sic eshte menaxhimi financiar dhe arketueshmeria.

Terheqim vemendjen tek llogaria 411 "kliente dhe llogari te arketueshme" qe ka nje vlere prej 1,2 miliard leke ose 10 milion euro, pothuajse gjysma e buxhetit total vjetor te bashkise qe permban borxhet e vjetra te ujesjellesit. Shifra te tilla flasin vetem per mos menaxhim financash, mos arritje arketueshmerie ne nivele alarmante pa dashur aspak te hyj ne detajet se si mundet kjo shifer te transpozohet ne menaxhimin ne terren te sherbimit dhe shfrytezimin e resurveve ne fjale pasi nuk eshte komptence teknike qe na perket.

Duhet theksuar se kjo vlere eshte hera e pare qe paraqitet ne bilancin e bashkise pas nje udhezimi te ndryshuar me per metodat e konsolidimit. Ne Keshill nuk eshte paraqitur asnjehere bilanci I sh.a Ujesjelles Kanalizime Shkoder edhe pse eshte kerkuar per shqyrtim ne shume mbledhje te buxhetit nder vite, arsyetimi klasik ka qene qe mund ta aksesojme on line duke qene e regjistruar si shoqeri tregtare.

Kjo e fundit eshte fjala kyce e diskutimit tim, ujesjellesi eshte shoqeri tregtare dhe ndryshe nga entet publike qe nuk mund te ri-organizojne borxhet pa aministim formal, ato mund ta bejne lehtesisht, edhe pse do te kishte nje impakt fiscal. Ajo qe une kuptoj nga kjo vlere eshte se sh.a UK nuk eshte nje kompani me rentabilitet financiar gje qe e ben jo atraktive karshi cdo pale- si investitor potencial ashtu edhe huadhenes sic eshte rasti bankes gjermane KFË e cial qe ne vitin 2019 ka miratuar nje kredi prej 19 milion euro shtetit per ujesjellesin e Shkodres por deri me sot nuk eshte luajtur te pakten nje gur. Projekti mund te miratohet ne parim, por institucionet kredidhenese nuk mund te shkojne pertej limiteve te politikave te riskut dhe nga miratimi ne parim deri ne disbursim jane disa hapa thelbesore qe duhet te kryhen. Shendeti financiar I kredimarresit eshte thelbesor ne gjykim.

Per me teper, besoj se ky borxh (I vjeter dhe me shume mundesi I fryre nga kamatvonesat nder vite) perfaqeson edhe shume kontrata te cilat efektivisht nuk jane me ekzistuese. Kjo do te thote qe verifikimi efektiv ne terren te linjave korrente nuk behet dhe nr I kontratave mbahet fiktivisht I fryre per te justifikuar edhe nr e punonjesve te nevojshem.

Per keto arsye, besojme se ka ardhur momenti qe te ngrihet nje grup pune qe te beje verifikimin e sakte te kontratatave dhe per pasoje te sistemoje edhe borxhin, se paku te beje nje vleresim te historikut te tij duke tentuar te fshije llogari me pa arketueshmeri apo edhe te provizionoje borxhin qe nuk ka pritshmeri arketimi. Kjo do ta bente vleren e ketij aktivi me realiste dhe do ndikonte pozitivisht ne raportet financiare si per shoqerine tregtare ashtu edhe per entin publik qe e mban kete shoqeri ne bilanc per efekt konsolidimi.

Nje tjeter ceshtje shume me rendesi qe verej eshte llogaria me vlere pothuajse njesoj me debitoret e ujesjellesit, mbi 10 milione euro, eshte llogaria 468 e cila permban borxhe nga taksat dhe tarifat

vendore. Nga keto mbi 20% jane borxhe te bartura nga ish komunat dhe nje vlere prej 140 milion jane te velipojes te cilat mbeten ende sot ne ajer sepse nuk korrespondojne me biznese apo familjare faktike por jane vendosur ne forma arbitrare. Ende sot nuk eshte e qarte nese keto akte administrative korrespondojne me faktin. Kjo sjelle shume probleme ne terren te cilat nuk kane te bejne aspak me menaxhimin financiar sa jane element bllokimi per sherbime qe keto individe apo subjekte mund te marrin nga pushteti lokal pasi disa prej tyre u figurojne detyrime qe nuk korespondojne me prona qe ato kane ne kete territor. Permenda Velipojen sepse eshte pika turistike me atraktive dhe me volumin me te madh te turzimit ne territorit tone. Kjo nuk do te thote qe nuk kane vlere te njejte problemet e njesive te tjera territoriale.

Per sa me siper ngarkojme bashkine qe te ngreje grupin e punes per verifikimin e borxheve te keqija dhe te ndermarre akte administrative per c'regjistrimi e tyre Brenda tagrave ligjor. Per diferencen, Bashkia te beje konsultime me entet pergjegjese dhe me pas kërkesa dhe lobing aktiv per aministim duke liruar keshtu perfundimisht taksapaguesin nga barra e vleresimeve fiskale arbitrare e jo profesionale te historise se para reformes territorial administrative.

Pika e fundit te cilen du ate vej ne evidence eshte vlera domethenese e gjobave te inspektoriatit te mbrojtes se territorit ne zonen e thethit njesia administrative shale.

Nga 2017- ta Jane gjobitur 26 subjekte me gjoba qe varjojne nga 5 milion deri ne 35 milion leke

Para se te bejme thirjen per marrje urgjente masash, deshiroj te bej evident thelbin e problemit. Thethi eshte zone e mbrojtur dhe nuk eshte sa I perket zhvillimit territorial ne kompetencen e bashkise Shkoder, ne kete rast administrate e zonave te mbrojtura dhe ministria e linjes miratojne nje plan zonal. Ne mungese te tij, individet dhe subjektet ne kete territor nuk mund te aplikojne per leje ndertimi prane bashkise. Deri sot qe flasim asnje mase nuk eshte marre per kete plan zonal.

Per me teper, pjesa dermuese e ketyre banoreve dhe investitoreve ne zone kane probleme pronesie te lidhura me probleme sistemike te bartura te sistemit kadastal te cilat po ashtu mbesin pa zgjidhje deri sot qe flasim. Zgjidhja, me aq informacion sa kemi marre informalisht, duhej te ishte gjitheperfshirese dhe jo bazuar ne raste individuale dhe institucionet kompetente hezitojne te veprojne.

Si rezultat, banoret dhe subjektet e zones se thethit te gjetur te gracke nga cdo kuader legjislativ dhe te munguar ne sherbime qe u perkasin me te drejte legjitime, kane kryer nderhyrje ne godinat e banimit dhe te biznesit. Kjo sigurisht eshte perkthyer ne shkelje administrative dhe subjektet jane penalizuar. E vetmja hallke qe ka mundur ti pergjigjet ligjit ishte ajo e penalizimit.

Ajo qe me ben shume pershtypje eshte mos marrja e asnje mase apo edhe lobingu nga ana e bashkise per te zgjidhur ngercin por e ka perjetuar pasivisht mungesen e vemendjes nga institucionet e tjera. Do deshiroja shume qe ky mos veprim te kete nota neglizhence dhe jo politike.

Per sa shpreha me siper mendojme detyra kryesore qe I japim ekzekutivit eshte marrja e masave per te kerkuar te drejten e ketyre banoreve per te zhvilluar pronen qe e kane me te drejte te Zotit dhe mos te penalizohen me tej jo vetem ne gjoba por edhe ne mungese zhvillimi per zonen nder me te rendesishmet te bashkise Shkoder sa I perket potencialit turistik.

Paralelisht, u bej thirje te gjithe insitucioneve aktore ne kete ceshtje qe ti japin drejtim situates dhe te kryejne detyren qe u ka vene ligji dhe detyren me te cilen jane moralisht te ngarkuar duke qene se kane mundesine te percaktojne fatin e nje pasurie te jashtzakonshme qe kemi trasheguar nga natyra.

Znj. Martini,thekson faktin që problem mbetet fakti që banorët e Thethit dhe Dukagjinit nuk kanë Çertifikata pronësie.Të dyja këto zona janë të mbrojtura tashmë ,si ish parku i Thethit ashtu edhe lugina e Shalës.Ajo mendon se përsa kohë nuk ekziston një certifikatë ,çdo gjë mbetet informale.

Edhe Z.Galiqi, mendon që të gjithë këshillëtarët duhet të nxisin iniciativën për të pasur një audit për ndërmarrjen e ujësjellsit,për të ditur se si funksionon dhe për të qënë sa me transparent.Ai i gjen propozimet e parashtruara nga Znj.Leqejza mëse të domosdoshme.

Po ashtu Z.Sokoli, i bën thirrje Kryetarit të bashkisë që të gjindet mënyra ,që këtyre banorëve t'i njihet prona.

Z.Vjerdha propozon që relacionit të bërë nga Znj.Leqejza t'i hartohet edhe një nismë dhe t'i dërgohet instancës përkatëse për zgjidhje konkrete.

Z.Spahia,shprehet plotësisht dakort për sa u tha nga Znj.Leqejza,sepse titujt e pronësisë frenojnë edhe zhvillimin e këtyre zonave.Ai thotë se, që nga fillimi i marrjes së detyrës ,ka adresuar këtë cështje me shumë seriozitet pasi janë marr shumë ankesa,dhe duke ditur edhe rëndësinë e saj. Shpreson shumë që të arrihet gjetja e një zgjidhjeje për këtë cështje kaq jetike për ato banorë dhe për gjithë bashkinë e Shkodrës.Por ky problem mbetet në dorë të Kadastrës dhe Bashkia vetëm mund të ngrej zërin për këtë.

Znj.Leqejza, mendon se të gjithë aktorët duhet të bëjnë pjesën e tyre,që t'i jepet zgjidhje një herë e mirë.

Znj.Dibra thotë se cështja është shumë sensitive dhe meriton shumë diskutim por mendon se janë larguar shumë temës për miratimin e këtij Pr/Vendimi.Ajo mendon se këto diskutime mund të bëhen në mbledhjet në vazhdim.

Kalohet në mendimin e Kryetarëve të grupeve ,të cilët shprehet pro miratimit dhe mbështesin komisionin. Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 26 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.
Miratohet

Vijohet me pikën 7. të rendit: Pr/Vendim: *"Për miratimin e vlerës së subvencionimit të qirasë dhe përjashtimin nga pagesa e qirasë të përfituesve të subvencionimit në raport me nivelin e të ardhurave për përfituesit e banesave sociale me qira,administruar nga bashkia Shkodër".*

Relaton Z.Vila, drejtor i drejtorisë së Shërbimit Social dhe Strehimin ne bashkinë Shkodër. sipas materialit të përgatitur nga administrata dhe jep sqarime të detajuara.
Z.Mandija në emër të komisionit shprehet pro.Po ashtu e dhe kryetarët e grupeve. Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 26 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.
Miratohet
Kalohet në pikën 8: Pr/Vendim: *"Për angazhimin e burimeve financiare të Bashkisë Shkodër për bashkëfinancim në aplikimin nr.Ref: EU4M-CFP1-A2;Për angazhimin për mbulimin e kostove të mirëmbajtjes së projektit dhe për autorizimin e kryetarit për lidhjen e kontratës së grantit".*
Përsëri fjalën e merr Z.Vila, i cili relaton sipas materialit të përgatitur nga administrata duke theksuar rëndësinë e këtij projekti.

Znj.Mandija Shprehet pro Pr/Vendimi dhe i ribën thirrje kolegëve këshillëtarë që të marrin pjesë në mbledhet e këshillit, sepse mospjesëmarrja e tyre ka sjellë shumë pengesa në lidhje me përfitime të ndryshme për qytetin e Shkodrës.
Z.Sokoli merr fjalën dhe shpreh shqetësimin e tij në lidhje me banesat që janë bërë për kominitetin rom-egjiptian prej më shumë se një viti por mbeten të pabanuara.
Z.Vila sqaron se problem mbetet fakti i moslidhjes së energjisë elektrike dhe matësat elektrik.Për këtë janë bërë shumë kërkesa pranë ministrisë ,madje është kërkuar edhe mbështetje nga këshilli.Jemi në pritje që furnizimi me energji të mos pengojë këto familje që të kenë shtëpitë e tyre.
Kalohet në mendimin e kryetarëve të grupeve:Znj.Dibra dhe Z.Sokoli shprehen dakort. Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 26 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.
Miratohet

Vijohet me pikën 9.të rendit të ditës. Pr/Vendim: *"Për shtesë në buxhetin e vitit 2022 e miratuar me VKB nr.3,datë 05.01.2022"Për miratimin e buxhetit të vitit 2022 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2022-2024 të Bashkisë Shkodër".*

Z.Vila relation dhe sqaron në mënyrë të detajuar se si do funksionojë projekti për shtëpitë – familje.
Në emër të komisionit Znj.Mandija shprehet se komisioni ka vërenjtur disa keqllogaritje në draftin e këtij projekti dhe so rrjedhojë kanë bërë edhe një kërkesë me qëllim që drejtoria të reflektojë dhe të kryejë ndryshimet e duhura, gjë që u realizua dhe përmirësua dhe tashmë jemi plotësisht dakort.
Kalohet në mendimin e Kryetarëve të grupeve ,të cilët shprehet pro miratimit dhe mbështesin komisionin. Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 26 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.
Miratohet

Vijohet me pikën 10.të rendit të ditës: Pr/Vendim: *"Për miratimin e ndryshimit të emërtimit të rruga e "Korpusit"në rruga "Kolë Mjeda".*

Fjala për Zv/Kryetarin Z.Deda,i cili relaton shkurtimisht mbi figurën e Z.Mjeda.

Z.Vjerdha ndërhyn dhe shprehet se ai personalisht ka bërë shumë kërkesa për emërtime /ndryshim emri rrugësh por asnjëra nuk ka mbërritur në këshill për miratim për arsye burokratike.

Z.Galiqi merr fjalën dhe vlerëson figurën e Z.Kolë Mjeda dhe duke marr shkas edhe nga Z.Vjerdha ai propozon ngritjen e një grupi këshilltarësh, që janë njohës të mirë të historisë së qytetit për të vlerësuar kërkesat për emërtimë rrugësh.Edhe Z.Sokoli ndan të njëjtin mendim dhe propozon që komisioni i jashtëm të bashkërendojë me komisionin e Këshillit Bashkiak.

Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 26 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.
Miratohet

Kalohet në diskutime jashtë rendit të ditës.

Z.Vukaj merr fjalën dhe i bën thirrje të gjithë të përzgjedhurve me votë në qytetin e Shkodrës, deputetëve e të gjithë personave që sadopak kanë mundësi të ngrejnë zërin përsa i përket ndryshimeve të fundit në lidhje me gjykatën e Apelit dhe asaj Administrative duke cënuar kështu të drejtat e gjithsecilit dhe njëkohësisht duke i rënë ndesh të drejtave themelore të njeriut të parashikuara në Kushtetutë. Po ashtu ky ndryshim absurd rrit edhe koston e aksesit në drejtësi për të gjithë qytetarët. Prandaj ai bën thirrje fuqishëm që të gjithë të zgjedhurit e qarkut të Shkodrës të bëhen zëri i qytetarëve të Shkodrës për këtë "padrejtësi".Ai propozon futjen për diskutim të cështjes në rendin e ditës ose mbledhjen e një seancë të dedikuar.

Z.Vjerdha risjell shqetësimin e tij dhe të shumë qytetarëve në lidhje me nepotizmin në Bashkinë e Shkodrës.Dhe pyetja e tij e drejtëpërdrejtë është; A do vazhdojë të ketë nepotizën edhe me Kryetarin e ri? Gjithashtu ai propozon që cdo punonjësi duhet kërkuar formulari i dekriminalizimit duke marr shkas nga disa persona të punësuar aty.

Z.Spahia thekson faktin se ai ka qënë gjithmonë kundër nepotizmit në cdo institucion ku ka kontribuar. Ai premton që nuk do ketë asnjë formë nepotizmi në rekrutimet e reja që do bëhet , kurse largimi është cështje më e ndërlikuar.Por mendon që fakti i mosmarrjes në punë me lidhje familjare është nisje e mirë për largimin e fenomenit. Kurse përsa i përket pyetjes së dytë ai mendon se duhet të tregohemi më të kujdesshëm sepse shumica dërmuese e nënpunësve në bashkinë e Shkodrës janë njerëz të përkushtuar, familjarë të rregullt dhe qytetar të denjë dhe meritojnë mbështetjen e këtij këshilli.

Fjalën e merr Znj.Dibra e cila dëshiron të falenderojë Bashkinë e Shkodrës dhe vlerëson bashkëpunimin me Universitetin në lidhje me marrjen e presidencës së konsorciumit të konferencës të rektorëve të Alpeve të Adriatikut. Falenderimi shkon për mikpritjen dhe mbështetjen që u dha nga stafi i bashkisë.

Kurse Z.Hasaj shpreh shqetësimin e tij në lidhje me krizën ushqimore që po përballet e gjithë bota.Ai të dijë a ka marr bashkia ndonjë masë ose a ka ndonjë projekt për rritjen e prodhimit të produktit ushqimor dhe blegtoral? Dhe a ka ndonjë projekt për nxitje të kultivimit të kulturave të

ndryshme ushqimore,dhënie grantesh ose subvencione? Po ashtu shqetësim mbetet edhe uji i pijshëm dhe kanalet kulluese ne Nj.Administrative Rrethina.

Z.Spahia shprehet se ai mendon se shërbimi më i mirë janë investimet e shtuara në zonat që kanë prodhimtari të lartë të produkteve bujqësore.Problem vazhdojnë të mbeten kanalet vaditëse, gjë që kërkon mbështetjen e ministrisë së bujqësisë. Së fundmi kemi paraqitur prioritetet tona për zonat më problemtike. Shpresojmë të marrim financimet që presim në këtë drejtim.

Z.Sokoli kërkon të dijë nëse është e mundur që edhe qyteti i Shkodrës të ketë kryepleq sepse mendon se ato i dinë më mirë hallet e problemet e qytetarëve.

Z.Deda ndërhyn dhe sqaron se ligji nuk e parashikon një gjë të tilë, prandaj nuk mund të merren iniciativa të tilla.

Z.Metushi rikthen në vëmendje një kërkesë prej 7 pikash të bërë para pak kohësh në lidhje me angazhimin dhe mbështetjen e rinisë në projekte dhe nismat e bashkisë. Ai propozon të ketë iniciativa përsa i përket përfshirjes së të rinjëve.

Z.Spahia shprehet që kërkesa do merret patjetër në konsideratë. Ai shton se gjatë këtyre 2-3 muajve ai ka patur takime të ndryshme me grupe të tilla interesi duke theksuar konsideratën e tij të lartë për cdo iniciativë, përfshirje dhe bashkëpunim me të rinjtë.

Fjalën e merr Znj.Doniku e cila shpreh shqetësimin e saj me shtimin e një kati në shkollën "Skënderbej",po ashtu edhe për kopshtin në Dobraç, ku nuk ka ujë të pijshëm.Edhe lirimi i trotuareve tek "Truma e Dugajve të reja"

Z.Spahija përgjigjet se e njeh problematikën dhe është ngritur një grup punë për këtë .Prioritet mbete lirimi i hapësirave publike. Paralelisht po punohet edhe për krijimin e hapësirave për tregëtarët ambulant.Kemi përgatitur edhe projekte për krijimin e tregjeve.

Znj.Leqejza përsërit për të disatën herë, shqëtësimin e "zaptimit" të sheshit para stadiumit.Gjithshtu ajo kërkon rikthimin për diskutim të planit të tarifimit të qarkullimit.

Pyetje dhe diskutime të tjera nuk ka. Znj.Kadija e deklaron mbledhjen të mbyllur.

Procesverbali, pasqyron në mënyrë të përmbledhur diskutimet e mbledhjes së këshillit bashkiak Shkodër të datës 13.06.2022. Bashkëlidhur këtij procesverbali, materiali i mbledhjes Audio.(DVD).

Procesverbali përmban 9 faqe dhe pasi lexohet, nënshkruhet pa vërejtje nga:

Sekretar ***KRYETARE***

Denis LESHA ***Brisela KADIJA***